



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT

REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 26-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 28.03.2024, në sallën numër 1, kati i 3-të, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Bytyqi, anëtare
7. Alban Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Diamant Bytyqi, nënkryetar i Komunës
2. Elmaze Behluli, DA
3. Rexhep Rexhepi, DBPZHR
4. Imri Semetishti, DUMB
5. Shkelzen Hajdini, DSHMS

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti *Behar Aliu*.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha se rendin e ditës e keni marrë me kohë, dhe e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 26-të e KPF-së.
2. Propozim Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Mehdi Zejnullahu” në Lipjan.
3. Propozim Vendim për miratimin e Planit lokal të veprimit për barazinë gjinore 2024-2026.
4. Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, ZK Grackë e Vjetër.
5. Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK Grackë e Vjetër.
6. Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës, ZK Lipjan.
7. Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK Lipjan.
8. Propozim Vendim për formimin e Komisionit të Ankesave.
9. Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale.
10. Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer për subvencionimin e qumështit.

Pastaj Kryesuesi tha sa e keni vërejtje apo plotësime rreth rendit te ditës

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës me pikës shtese dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për Aprovoi rendin e ditës:

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 24-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për Aprovoi Ekstraktin nga mbledhja e 24-të të KPF-së

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, tha se vazhdojmë me pikat tjera te rendit te ditës.

II

Propozim Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Mehdi Zejnullahu” në Lipjan.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdinit, drejtor i DSHPS-së ,i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Alban Salihu, tha se e kam lexuar me vëmendje statutin, por e kam pa qe ne statut ende funksionon AMF në Banullë e cila nuk është funksionale. A duhet te ndryshohet kjo.

Arsim Jashari, tha se me ndryshimin e statudit a do te ndryshohet edhe struktura organizative e QKMF-së.

Egzona Bytyqi, tha edhe unë e kam lexuar dhe analizuar statutin e QKMF-së, është bërë një punë e mirë, është mirë qe janë ruajte disa sektorë nuk janë shujtuar dhe e mbështes.

Shkelzen Hjadini, tha se po me ndryshimin e statudit do te ndryshohet edhe struktura organizative, ndërsa sa i përket AMF, në Bnaullë dhe Smallushë nuk i kemi hiç, sepse i kemi lenë qe ne te ardhmen mos po i aktivizojmë.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat prezentë vota për, aprovoi propozimin

III

Propozim Vendim për miratimin e Planit lokal të veprimit për barazinë gjinore 2024-2026.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Diamant Bytyqit nënkryetar i komunës i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se një propozim vendim i mirë ne si grup i PDK-së, do ta mbështesim.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi 7 vota për aprovoi propozimin

IV

Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, ZK Grackë e Vjetër.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semeishtit DUPH, i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se para duhet te ceket se për cilat kategori do te behet sakë dhe e dyta është mire te neni i 5 i vendimit te pagesat e komisionit te ceket saktë cili ligj, pasi qe ne në komision po vijmë qe sa kohe dhe nuk po paguhemi.

Alban Salihu, tha se edhe unë pajtohen me parafolësin se duhet te ceket saktë se cilat kategori do te përfitojnë dhe e dyta ju po i referoheni si objekt aty do te jene shume objekte jo një.

Imri Semetishti, tha se ky vendim është vetëm për kategoritë e dala nga lufta. Aty do te jenë disa objekte.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat prezentë vota për, aprovoi propozimin

V

Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK Grackë e Vjetër.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishtit DPUMM i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, atë që e ceka me herët të neni i 5te i vendimit duhet të ndryshohet pasi që ne që sa kohe jemi në komisione dhe nuk po ka pagesa.

Imri Semetishti, tha se nuk po kemi mundësi të bëjmë pagesat edhe ne jemi në hall me këtë çështje.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se po presim që të behën rregulloret e reja dhe të fillojmë me pagesa se jemi keq sa i përket pagesave.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat prezentë vota për, aprovoi propozimin

VI

Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës, ZK Lipjan.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishtit DPUMM i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Alban Salihu, tha se a ka mundësi që një pronar ta bllokojë të gjithë projektin në Lipjan.

Imri Semetishti, tha se po mundet me bllokuar. Por në operatorin i cili do të marrë për ndërtim do të epim një afat 6 muaj për të bërë marrëveshje me pronaret.

Daut Azemi, kryesues i KPF-së, tha se i kam dy pyetje gjatë takimit me këta banorë si ka qenë disponimi i tyre. Dhe e dyta kur të aplikojnë kompanitë a lejon ligji që nëse nuk arrijnë marrëveshje i pari me ta lejuar të dytën.

Imri Semetishti, tha se gjatë takimit me këta banorë, ka pas prej atyre që kanë pas disponim të mirë por edhe prej atyre që kanë qenë në hamendje skanë ditë si të veprojnë. Ndërsa ligji i prokurimit nuk e lejon të dytën.

Alban Salihu, a e posedon komuna projektin se ma sa po shihet do të ketë ndryshim të projektin. A do të rrënohet objekti të Çekini?

Imri Semetishti, tha se po e ka komuna projektin dhe mund ta shihni në zyrë të ne. Po objekti i çekini do të rrënohet ?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat prezentë vota për, aprovoi propozimin

VII

Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK Lipjan.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishit, DPUMM i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat prezentë vota për, aprovoi propozimin

VIII

Propozim Vendim për formimin e Komisionit të Ankesave.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishit, DPUMM i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat prezentë vota për, aprovoi propozimin

IX

Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Elmaze Behluli, DA i cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ne si grup i PDK-së e mbështesim këtë propozim dhe propozojmë që në fund të vitit të stimulohen dhe me ndonjë bonus pasi që zyrtaret janë me paga keq

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat prezentë vota për, aprovoi propozimin

X

Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer për subvencionimin e qumështit

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rexhep Rexhepit, DBPZHR i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit se KPF-ja me të gjitha votat prezentë vota për, aprovoi propozimin

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 11:55

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi